



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kuvendi

PROJEKT LIGJ

NR. ____/2018

PËR

**RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT
“HEKURUDHAT SHQIPTARE - REHABILITIMI I LINJËS
HEKURUDHORE TIRANË – DURRËS DHE NDËRTIMI I LINJËS
HEKURUDHORE PËR NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR
TË TIRANËS”, NË KUADËR TË GRANTIT TË INVESTIMIT
NGA FONDI I PËRBASHKËT EVROPIAN
I BALLKANIT PERËNDIMOR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë – Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, me një grant investimi nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor, në shumën 35 435 000 (tridhjetë e pesë milionë e katërqind e tridhjetë e pesë mijë) euro, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI